



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**  
**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 2188 prot.

Tiranë, më 31 .07 .2024

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 3467/1, DATË 23.01.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË  
TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË  
ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. ISUF TAGA”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Isuf Taga nr. 2084 prot., datë 20.07.2022, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magistratëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3467/1 prot., datë 23.01.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Isuf Taga”, bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja “a”, nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kurbin, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja nr.3, Laç;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

